

VENDIM
Nr. 14, datë 31. 1.2019

MBI SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2018 DHE PLANIT 10-VJEÇAR 2018–2027 TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHOQËRISË ALBGAZ SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12; nenit 46 dhe nenit 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 8 dhe nenit 9, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.1.2018, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31. 1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me shqyrtimin e planit të zhvillimit të investimeve për vitin 2018 dhe planit 10-vjeçar 2018–2027 të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAZ sh.a.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 4.6.2018, filloi procedurën për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAZ sh.a. dhe me vendimin nr. 121, datë 4.6.2018, filloi procedurën për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAZ sha.

- ERE, me shkresën nr. 454 prot., datë 14.6.2018, bëri me dije shoqërinë ALBGAZ sh.a., për vendimmarrjet e sipërcituara, në të cilat pasqyrohej detyrimi për të plotësuar dokumentacionin e munguar sipas kushteve të vendosura në dispozitivët e vendimeve brenda afateve të përcaktuara.

- Në përgjigje të korrespondencës sipërcituar të ERE-s shoqëria ALBGAZ sh.a. me shkresën me nr. 454/1 prot. hyrës, datë 13.7.2018, ka informuar ERE-n mbi përmbushjen e detyrimeve mbi Planin e Investimeve për vitin 2018, si dhe Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit. ALBGAZ sh.a. për vitin 2018 parashikon projekte të reja në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, si dhe trajnimin e stafit në kuadër të investimeve strategjike (Gas Masterplan), ku gazsjellësi TAP AG do të ketë rol suportues në implementimin e projektit.

- Shoqëria ALBGAZ sh.a., në korrespondencën e saj nr. 454/1 prot. hyrës, datë 13.7.2018, ka përcjellë gjithashtu në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendosur në pikën 2 të vendimeve nr. 120 dhe nr. 121, datë 4.6.2017, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në datën 20.10.2018, për arsyet e sipërcituara dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 454/4 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.1.2019.

- Duke marrë në konsideratë kërkesat e shoqërisë ALBGAZ sh.a., për shtyrjen e afatit të plotësimit të dokumentacionit të munguar dhe rrethanat në të cilat ishte kjo shoqëri, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, vendosi shtyrjen e afateve për plotësimin e këtij dokumentacioni deri në datën 20.10.2018 dhe me vendimin nr. 235, datë 2.11.2018, vendosi shtyrjen e afateve për plotësimin e këtij dokumentacioni deri në datën 20.1.2019.

- Referuar këtyre vendimeve konstatohet se, afatet e përcaktuara për plotësimin e këtij dokumentacioni nga shoqëria ALBGAZ sh.a., janë tejkaluar, gjithashtu kësaj shoqërie dhe përfaqësuesve të saj i është rikujtuar disa herë detyrimi për plotësimin në kohë, të dokumentacionit të munguar.

- ALBGAZ sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 10 prot., datë 24.1.2019, bën me dije se do të kryejë disa ndryshime në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit, të cilat janë:

1. Marrëveshja e Ndërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) ALBGAZ sh.a. dhe “SNAM SPA”.

2. Finalizimi i marrëveshjes së Mirëmbajtjes ndërmjet gazsjellësit TAP AG dhe shoqërisë së përbashkët ALBGAZ sh.a. dhe “SNAM SPA”.

3. Shtyrja e investimit për rikonstruksionin e zyrave në Fier të shoqërisë ALBGAZ sh.a., për vitin 2019. Investimi për rikonstruksionin e zyrave në Fier nuk u krye gjatë 2018 siç ishte parashikuar sepse kusht për këtë projekt ishte dhe finalizimi i marrëveshjeve të cituara në pikat 1 dhe 2.

- Shoqëria ALBGAZ sh.a., kërkon shtyrjen e afatit për dërgimin e Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të rishikuar, deri më datë 31.10.2019, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- Plani i investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAZ sh.a., ka mungesa të theksuara dokumentacioni dhe argumentesh edhe pas këtyre shtyrjeve siç konsiderohet thelbësore miratimet e këtyre planeve nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe duke qenë se viti 2018 është mbyllur jemi në kushtet se janë ezauruar afatet kohore për mundësinë e miratimit të planit të 2018.

- Sa i takon Planit 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, duke marrë në konsideratë sa parashtruar nga ALBGAZ sh.a., në shkresën e fundit dhe në mënyrë që mos ndikohet procesi i certifikimit të ALBGAZ sh.a., është vlerësuar që të merret në konsideratë kërkesa për shtyrjen e afatit për dërgimin e Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të rishikuar deri me datë 31.10.2019, me kushtin që të përditësohet për periudhën 2019 – 2028, siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAZ sh.a.

2. Pika 2 e vendimit nr. 235, datë 2.11.2018, ndryshon dhe bëhet:

- ALBGAZ sh.a., të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 31.10.2019: miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2019–2028, që reflekton ndryshimet në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit sipas shkresës nr. 10 prot., datë 24.1.2019,

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë ALBGAZ sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti